

296  
14 04 17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 46, datë 12.4.2017

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS  
SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË  
PASTRIMIT TË PARAVE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:


1. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave të jetë, gjithsej, 39 veta.
4. Urdhri nr.93, datë 21.2.2014, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**STRUKTURA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT  
TË PASTRIMIT TË PARAVE**



**ORGANIKA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT  
TË PASTRIMIT TË PARAVE**

<b>POZICIONI</b>	<b>KATEGORIA</b>	<b>NUMRI</b>
<b>I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM</b>		<u><b>1</b></u>
<b>II. DREJTORIA E ANALIZËS STRATEGJIKE DHE TRANSAKSIONEVE TË DYSHIMTA</b>		<u><b>(17)</b></u>
DREJTOR		1
<b>SEKTORI I ANALIZËS SË TRANSAKSIONEVE TË DYSHIMTA</b>		<b>(12)</b>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	11
<b>SEKTORI I ANALIZËS STRATEGJIKE</b>		<b>(4)</b>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3
<b>III. DREJTORIA E ANALIZËS SË PËRPUTHSHMËRISË DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT</b>		<u><b>(10)</b></u>
DREJTOR		1
<b>SEKTORI I ANALIZËS SË PËRPUTHSHMËRISË</b>		<b>(5)</b>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	4
<b>SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT</b>		<b>(4)</b>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
<b>IV. DREJTORIA JURIDIKE, MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE TRAJNIMEVE</b>		<b>(7)</b>
DREJTOR		1
SPECIALIST	IV-a	6
<b>V. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE</b>		<b>(4)</b>
PERGJEGJES SEKTORI	IIIa/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SHOFER		1
<b><u>PUNONJËS GJITHSEJ</u></b>		<b>39</b>

**KRYEMINISTRI**

**EDIRAMA**